



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 159, Datë 09/08/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 71, datë 22.05.2018, e Znj. L. M., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “gjinisë” dhe “moshës”, nga ana e Z. I. A., Drejtor i I.E.V.P, Vlorë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se Znj. L. M., e datëlindjes 03.10.1963, në Vlorë, është e diplomuar për “Mësuesi”, dega “Cikël i Ulët” dhe aktualisht është duke ndjekur studimet pasuniversitare për Master Profesional, dega “Psikologji Klinike”, pranë IAL jo publike. Ajo ka punuar prej datës 06.06.2011, pranë I.E.V.P., Vlorë, duke mbajtur pozicione të ndryshme pune. Në datën 03.11.2016, ankuesja është emëruar “specialiste edukimi”, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 31.03.2018, moment në të cilin, nëpërmjet Urdhërit nr. 2898/1, datë 19.03.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ajo është liruar nga detyra, me motivacion *“mospërputhje e kriterëve arsimore me funksionin organik”*.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesja pretendon se është liruar padrejtësisht nga detyra dhe është diskriminuar për shkak të moshës dhe gjinisë, nga ana e Drejtorit të I.E.V.P., Vlorë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 71, datë 22.05.2018, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7², të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Drejtorit të I.E.V.P. Vlorë dhe për dijeni ankueses dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, me shkresën nr. 719/1, datë 23.05.2017, ku kërkohet informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesja, si dhe iu kërkua të dërgoheshin aktet e poshtëcituar:
- Urdhëri i emërimit dhe i lirimit nga detyra të Znj. L. M.;
 - Urdhëri nr. 4117, datë 20.07.2001, i Ministrit të Drejtësisë “Për disiplinimin e funksioneve organike në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe i Riedukimit, për përcaktimin e kriterëve arsimore dhe eksperiencës për emërimet në detyrë dhe për kompetencat e titullarëve”;
 - Urdhëri nr. 6220/1, datë 17.08.2009, i Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kriterëve të veçanta për përzgjedhjen e stafit të Sektorit të Kujdesit Social në IEVP”;
 - Shkresa nr. 1731, datë 07.12.2017, e I.E.V.P., Vlorë “Propozim për lirim nga detyra të një punonjësi civil”;
 - Lista e punonjësve të larguar nga puna me të njëjtin motivacion me ankuesen. Në këtë listë të shënohet pozicioni i punës, që këta persona kanë mbajtur dhe ditëlindja e secilit prej tyre;

² Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Lista emërore e specialistëve të edukimit pranë I.E.V.P. Vlorë, ku të jetë shënuar edhe dita e lindjes së tyre. Bashkëlidhur listës është kërkuar të dërgohen kopje të diplomës bachelor dhe master të secilit prej tyre;
 - Urdhëri i emërimit të personit, që aktualisht punon në pozicionin e punës së ankueses, si dhe diploma e tij bachelor dhe master;
 - Çdo akt tjetër administrativ, që ka lidhje me çështjen në shqyrtim.
1. Në përgjigje të shkresës nr. 719/1, datë 23.05.2017, së Komisionerit, Drejtori i I.E.V.P. Vlorë, dërgoi shkresën nr. 800, datë 29.05.2018, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se I.E.V.P Vlorë ka bërë propozim, në datën 07.12.2017, për shkëputjen nga puna të Znj. L. M..

Ky propozim është kryer konform kërkesave të parashikuara në Urdhërin nr. 4117, datë 20.07.2001, të Ministrit të Drejtësisë “Për disiplinimin e funksioneve organike në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për përcaktimin e kriterëve arsimore dhe eksperiencës për emërimet në detyrë dhe për kompetencat e titullarëve”, i ndryshuar, dhe në referencë të shkresës nr. 7765, datë 23.08.2017, së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku theksohet se për punonjësit, të cilët nuk kanë arsimin përkatës sipas kërkesave të funksionit organik, të përgatitej praktika e plotë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke respektuar afatet e njoftimit të parashikuara në aktet ligjore e nënligjore. Në këto kushte, I.E.V.P. Vlorë i ka bërë njoftimin ankueses, në datën 01.12.2017, duke vënë në dukje faktin se ka mospërputhje të arsimit me kriterin e parashikuar në pozicionin e punës që është emëruar dhe Znj. L. M. ka nënshkruar për njoftimin e marrë.

Në shkresën nr. 800, datë 29.05.2018, të I.E.V.P. Vlorë, theksohet fakti se ky institucion ka dërguar shkresën nr. 42, datë 16.01.2018, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku është shprehur dëshira për të mos shkëputur marrëdhëniet e punës me Znj. L. M.. Në vijim, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar Urdhërin nr. 2898/1, datë 19.03.2018, për lirin nga detyra të Znj. L. M. me motivacion “*mospërputhje të kriterëve arsimore me funksionin organik*”.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 719/1, datë 23.05.2017, së Komisionerit, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dërgoi shkresën nr. 5258/1, datë 31.05.2018, nëpërmjet së cilës e bën më dije Komisionerin se mbështetur në Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr. 4117, datë 20.07.2001 “Për disiplinimin e funksioneve organike në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për përcaktimin e kriterëve arsimore dhe eksperiencës për emërimet në detyrë dhe për kompetencat e titullarëve”, i ndryshuar, pozicioni i punës “specialist edukimi” kërkon arsimimin e lartë në Fakultetin e Shkencave Sociale, dega Psikologji, Punë Sociale, Mësuesi, Sociologji

ose Filozofi. Znj. L. M. ka përfunduar studimet në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, duke fituar diplomën e Nivelit të Parë në Mësuesi për Arsimin Fillor (cikli i ulët). Në këto kushte, ajo është liruar nga detyra për arsye të mospërputhjes së kriterëve arsimore me kërkesat e funksionit organik dhe jo për diskriminim për shkak të “gjinisë” dhe “moshës”.

C. Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhërin nr. 120, datë 18.06.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit pranë I.E.V.P Vlorë, për verifikimin e pretendimeve të ankueses L. M.”, në datën 22.06.2018, u krye inspektim pranë I.E.V.P. Vlorë.

Objekti i inspektimit konsistonte në çështjet e poshtëcituar:

1. Lista emërore e përgjegjësit të sektorit dhe të specialistëve të edukimit, të Sektorit të Çështjeve Shoqërore, që punojnë aktualisht pranë I.E.V.P. Vlorë. Në këtë listë të jetë shënuar arsimi, ditëlindja dhe momenti i punësimit pranë IEVP Vlorë. Marrja në administrim e kopjeve të diplomës bachelor dhe master të secilit prej tyre;
2. Informacioni mbi mënyrën se si është vepruar me Z. E. M., specialist edukimi pranë IEVP Vlorë, i cili ndodhej në të njëjtat kushte me ankuesen. Administrimi i kopjeve të akteve përkatëse.
3. Kopje e strukturës organike të mëparshme dhe aktuale të I.E.V.P. Vlorë, ku të jenë reflektuar emrat e punonjësve, ditëlindja, arsimi universitar, vjetërsia në punë, data e emërimit në sistemin e burgjeve, si dhe numri personal i dosjes.
4. Mbledhja dhe administrimi i të dhënave dhe informacioneve të tjera, që kanë lidhje me ankesën nr. 71, datë 22.05.2018, e Znj. L. M.

Gjatë inpektimit të kryer pranë I.E.V.P. Vlorë, inspektorët e Komisionerit morën informacionin përkatës mbi çështjet që përbënin objektin e inspektimit.

Lidhur me çështjen e parë të objektit të inspektimit, përfaqësuesit e Komisionerit u bënë me dije mbi faktin, se në bazë të strukturës aktuale të I.E.V.P Vlorë, të miratuar me Urdhërin nr. 58, datë 24.04.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikes së Drejtorisë së Përgjithme të Burgjeve dhe institucioneve në varësi të saj”, Sektori i Çështjeve Shoqërore përbëhej nga përgjegjësi i sektorit dhe 4 specialistë. Inspektorët e Komisionerit morën në administrim dokumentacionin e nevojshëm, të secilit prej tyre. Ankuesja L. M. është liruar nga detyra për shkak se nuk përmbushte kriterin arsimor të përcaktuar në aktet përkatëse nënligjore. Ankuesja ka përfunduar studime për mësuesi, cikli i ulët. Në vendin e saj është emëruar Znj. F. C., e cila ka përfunduar studimet bachelor për Sociologji dhe ka kryer master profesional

“Administrimi i Institucioneve Sociale në Sistemin e Drejtësisë”, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale (UT).

Në lidhje me çështjen e dytë që përbën objekt inspektimi, personat përgjegjës pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore informuan se Z. E. M., ka përfunduar arsimin e lartë në degën Histori-Gjeografi. Pavarësisht se ndaj tij u fillua procedura për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, sikurse për ankuesen, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve ai u transferua pranë I.E.V.P. Rrogozhinë. Inspektorët e Komisionerit kërkuan një kopje të dosjes personale të Z. E. M., por dosja e tij ishte transferuar pranë I.E.V.P. Rrogozhinë. Z. E. M., sikurse ankuesja kanë qenë specialistë edukimi pranë I.E.V.P. Vlorë dhe arsimit i tyre nuk përputhej me pozicionin e tyre të punës. Të pyetur nëse kishte punonjës të tjerë, arsimit i të cilëve nuk përputhej me kriteret e përcaktuara për pozicionin e punës, strukturat përgjegjëse të I.E.V.P Vlorë, u shprehën se Z. D. E., me detyrë Kartelist, pranë Sektorit Juridik, ka përfunduar studimet e larta për Ekonomi-Financë. Në bazë të Urdhërit nr. 6783, datë 13.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, për këtë funksion apo pozicion pune është përcaktuar kriteri arsimor jurist.

Në lidhje me çështjen e tretë të objektit të inspektimit, inspektorët e Komisionerit morën në administrim një kopje të strukturës organike të I.E.V.P. Vlorë, sipas specifikimeve përkatëse, të përcaktuara në Urdhërin e Komisionerit. Në strukturën organike janë të reflektuar emrat e punonjësve, ditëlindja, arsimit universitar, vjetërsia në punë, data e emërimit në sistemin e burgjeve, si dhe numri personal i dosjes.

D. Në vijim të inspektimit të kryer pranë I.E.V.P. Vlorë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr. 968, datë 06.07.2018, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ku iu kërkua informacion lidhur me Z. E. M. dhe Z. D. E., të cilët sikurse ankuesja nuk përmbushnin kriterin arsimor për pozicionin e punës, por pavarësisht kësaj, i pari është transferuar pranë I.E.V.P. Rrogozhinë, ndërsa i dyti vazhdon të punojë pranë I.E.V.P. Vlorë, në të njëjtën detyrë.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 968, datë 06.07.2018, të Komisionerit, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dërgoi shkresën nr. 6996/1, datë 11.07.2018, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin vetëm në lidhje me Z. D. E., ndërkohë që nuk jep asnjë informacion mbi transferimin e Z. E. M. nga I.E.V.P. Vlorë, në I.E.V.P. Rrogozhinë.

Lidhur me çështjen e Z. D. E., Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve e bën me dije Komisionerin se bazuar në Urdhërin nr. 58, datë 24.04.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës e të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, pozicioni “Kartelist” kërkon arsimin e mesëm.

Në shkresë theksohet fakti se Z. D. E. është diplomuar në degën Ekonomi-Financë dhe ka filluar punë në këtë pozicion para miratimit të Urdhërit nr. 6783, datë 13.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në IEVP” dhe për pasojë ky urdhër nuk ka fuqi prapavepruese. Njëkohësisht në shkresë theksohet fakti se Znj. L. M. është liruar nga detyra për arsye të mospërputhjes së kriterëve arsimore me kërkesat e funksionit organik dhe jo për si pasojë e diskriminimit, për shkak të gjinisë dhe moshës, sikurse pretendohet nga ana e saj.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Znj. L. M. ka punuar që prej datës 06.06.2011, pranë I.E.V.P., Vlorë, në pozicione të ndryshme pune. Në datën 03.11.2016, ankuesja është emëruar “specialiste edukimi”, detyrë, të cilën e ka ushtruar deri në datën 31.03.2018, moment në të cilin, nëpërmjet Urdhërit nr. 2898/1, datë 19.03.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ajo është liruar nga detyra, me motivacion “*mospërputhje e kriterëve arsimore me funksionin organik*”.

Referuar dokumentacionit të depozituar pranë Komisionerit në cilësinë e provës, rezulton se Znj. L. M. është e diplomuar për “Mësuesi”, Dega “Cikël i Ulët” (me kohë të pjesëshme) pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë dhe aktualisht është duke ndjekur studimet pasuniversitare për Master Profesional, dega “Psikologji Klinike”, pranë IAL jo publike. Në referencë të shkresës nr. 7765, datë 23.08.2017, së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve³, I.E.V.P Vlorë ka dërguar pranë këtij institucioni, fillimisht shkresën nr. 1679, datë 23.11.2017, ku bëhej propozimi

³ Në shkresën nr. 7765, datë 28.08.2017, të DPB, pika 2, theksohet se për punonjësit që nuk kanë arsimin përkatës, sipas kërkesave të funksionit organik të përgatitet praktika e plotë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Kjo në referencë të Urdhërit nr. 58, datë 24.04.2017, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës e të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”;

për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për Znj. L. M.⁴. Në vijim, I.E.V.P. Vlorë ka dërguar shkresën nr. 1731, datë 07.12.2017, “Propozim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në përfundim të afatit të njoftimit”, nëpërmjet së cilës propozohet lirimi nga detyra i ankueses dhe Z. E. M., me motivacion “*mospërshtatje e arsimit me kërkesat e funksionit organik*”. Në bazë të Urdhërit nr. 2898/1, datë 19.03.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Znj. L. M. lirohet nga detyra me motivacionin e mësipërm, ndërkohë që Z. E. M. transferohet me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, pranë I.E.V.P., Rrogozhinë.

Nëpërmjet e-mailit të Përgjegjës të Sektorit të Burimeve Njerëzore, të I.E.V.P. Vlorë⁵ drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve rezulton se përveç dy punonjësve të sipërpërmendur, figuronin edhe 2 punonjës të tjerë që nuk plotësonin kriterin arsimor për pozicionin e punës që mbanin pranë I.E.V.P. Vlorë, përkatësisht: Z. D. E. me detyrë kartelist dhe Z. K. D. me detyrë elektromekanik.

Mbështetur në Urdhërin nr. 58, datë 24.04.2017, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës e të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”, Sektori i Çështjeve Shoqërore pranë I.E.V.P. Vlorë është i përbërë nga 1 (një) përgjegjës sektori dhe 4 (katër) specialistë. Arsimi i tre prej specialistëve është i specifikuar shprehimisht në Urdhër, ku 1 (një) specialist duhet të ketë arsimim si punonjës social, 2 (dy) specialistë duhet të kenë arsimim psikolog dhe një specialist është cilësuar si “specialist edukimi”, pa përcaktuar arsimin përkatës. Struktura e sipërpërmendur është përcjellë pranë I.E.V.P-ve, me shkresën nr. 4363, datë 19.05.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Në vijim të aktit të sipërpërmendur, ka dalë Urdhëri nr. 6783, datë 13.11.2017, i Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, në pikat 1 dhe 6, të së cilit përcaktohet shprehimisht, si më poshtë:

“1. Kriteret e posaçme për pozicionet e punës në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, të jenë si vijojnë:

Përgjegjës i Sektorit Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale.

të Çështjeve Shoqërore Eksperiencë punë mbi 5 vjet

⁴ Në këtë periudhë kohore ka hyrë në fuqi Urdhëri nr. 6783, datë 13.11.2017, i Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, ku përcaktohen me hollësi kriteret arsimore për të gjitha pozicionet e punës në I.E.V.P-të.

⁵ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Z. L. Q.) është njoftuar me e-mailin e datës 03.09.2017, nga Sektori i Burimeve Njerëzore të I.E.V.P. Vlorë, lidhur me gjendjen arsimore të Z.D. E. dhe Z. K. D.

Specialist

Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale dega Psikologji, eksperiencë punë mbi 2 vjet;

Specialist

Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale/Punë Sociale, eksperiencë punë mbi 2 vjet.”

.....

6. Të gjitha aktet nënligjore që janë në kundërshtim me këtë Urdhër, shfuqizohen.”

Për sa më sipër, Komisioneri ka konstatuar faktin se në bazë të Urdhërit nr. 6783, datë 13.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, Znj. L. M. nuk mund të qendronte në pozicionin e saj të punës, pasi nuk plotësonte kriterin arsimor për këtë pozicion pune, por njëkohësisht Komisioneri gjykon se ajo nuk është trajtuar njëlloj, në krahasim me punonjës të tjerë, të cilët janë ndodhur në të njëjtën situatë me të.

Mbështetur në dokumentacionin e administruar gjatë inspektimit të kryer pranë I.E.V.P. Vlorë, rezulton se trajtimi ndaj së cilit është ekspozuar Znj. L. M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë, është i pabarabartë e disfavorizues, pasi në pozitë të njëjtë apo të ngjashme me të, kanë qenë edhe punonjës të tjerë të I.E.V.P. Vlorë, të cilët prekeshin nga Urdhëri nr. 6783, datë 13.11.2017, i Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, por pavarësisht kësaj, ata janë trajtuar ndryshe nga ankuesja. Këta punonjës janë:

1. Z. E. M., ish-specialist pranë Sektorit të Çështjeve Shoqërore, pranë I.E.V.P. Vlorë, me arsim histori-gjeografi, i cili nuk u lirua nga detyra, sikurse Znj. L. M., por u transferua në I.E.V.P. Rrogozhinë. Për këtë punonjës, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk dha asnjë shpjegim, përse ishte trajtuar ndryshe nga Znj. L. M., pavarësisht se mbanin të njëjtin pozicion pune, me të njëjtat kriterë arsimore.
2. Z. Fako Fakaj, Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve Shoqërore, pranë I.E.V.P. Vlorë, profesioni i parë, i të cilit është agronom i lartë⁶, ndërkohë që në vitin 2008 ka përfunduar studimet e larta pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës, të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, në degën Biologji-Kimi. Kriteri arsimor për pozicionin e tij të punës

⁶ Referuar Diplomës Nr. 7106, datë 25.03.1995, të lëshuar nga Fakulteti i Agronomisë, të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

është “*Diplomë e nivelit të dytë në Fakultetin e Shkencave Sociale*”. Z. Fakaj vazhdon të punojë ende pranë I.E.V.P. Vlorë, në të njëjtin pozicion pune dhe as nuk figuron të jetë pjesë e listës së punonjësve të I.E.V.P. Vlorë që nuk plotësojnë kriterin arsimor.

3. Z. D. E., Kartelist pranë Sektorit Ligjor, të I.E.V.P. Vlorë, i cili nuk plotëson kriterin arsimor, të përcaktuar në Urdhërin nr. 6783, datë 13.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”, ku përcaktohet shprehimisht se specialist/kartelist pranë Sektorit Ligjor të I.E.V.P. Vlorë duhet të ketë diplomë të nivelit të parë në Fakultetin e Drejtësisë. Z.D. E. vazhdon ende të punojë në pozicionin e tij të punës si kartelist.
4. Z. K. D., punon në pozicionin “elektromekanik” pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve pranë I.E.V.P. Vlorë. Z. K. D. ka përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm, ndërkohë që në Urdhërin nr. 6783, datë 13.11.2017, të Ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale” për këtë pozicion pune kërkohet arsimi i mesëm profesional.

Për sa më sipër, rezulton se Znj. L. M. dhe Z. E. M., ish-specialistë të Sektorit të Çështjeve Shoqërore, pranë I.E.V.P. Vlorë janë vlerësuar se nuk e plotësonin kriterin arsimor për pozicionin e tyre të punës. Ndërkohë që për Znj. L. M. është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për Z. E. M. është vendosur transferimi në I.E.V.P. Rrogozhinë. Komisioneri gjykon se ankuesja është trajtuar dukshëm në mënyrë të ndryshme dhe të disfavorshme, në kushte e rrethana të njëjta me Z. E. M.. Njëkohësisht vlen të theksohet fakti se, kriterin arsimor për pozicionet e tyre të punës nuk e plotësonin edhe Z.D. E. dhe Z. K. D.. Por, edhe këta 2 punonjës, pavarësisht se janë në të njëjtat kushte si Znj. L. M., vazhdojnë ende të punojnë në pozicionet e tyre të punës. Sërisht rezulton se trajtimi i tyre është dukshëm më i favorshëm se Znj. L. M.. Ndërkohë që, bie në sy fakti se edhe Përgjegjësi i Sektorit të Çështjeve Shoqërore pranë I.E.V.P. Vlorë nuk e plotëson kriterin arsimor, por emri dhe të dhënat e tij nuk figurojnë, as në shkresat që I.E.V.P. Vlorë ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe as në e-mailin e datës 03.09.2017, e dërguar nga Sektori i Burimeve Njerëzore të I.E.V.P. Vlorë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjykon se ankuesja L. M. i është

ekspozuar një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe të disfavorshëm, nga ana e I.E.V.P. Vlorë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 71, datë 22.05.2018, e Znj. L. M. pretendohet diskriminim, për shkak të “gjinisë” dhe “moshës”, nga ana e Z. I. A., Drejtor i I.E.V.P, Vlorë.

“Gjinia” dhe “mosha” janë dy prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

1. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjinisë”, Komisioneri gjykon se “gjinia” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme që e justifikojnë si të tillë.

2. Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “moshës”, Komisioneri gjykon se “mosha” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “gjininë”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se ankuesja pavarësisht se ka qenë në kushte të njëjta me punonjës të tjerë të I.E.V.P. Vlorë, është trajtuar ndryshe. Gjatë analizimit të provave rezultoi se 4 (katër) punonjës të tjerë të gjinisë mashkullore, përkatësisht Z. E. M., Z. F. F., Z. D. E. dhe K. D., pavarësisht se nuk plotësonin kriterin arsimor për pozicionin e tyre të punës, janë mbajtur në punë dhe nuk janë liruar nga

detyra, sikurse është vepruar për Znj. L. M.. Nisur nga fakti se punonjësit e trajtuar në mënyrë të favorshme i përkasin gjinisë mashkullore dhe e vetmja punonjëse, e cila është trajtuar ndryshe në të njëjtat kushte e rrethana, i përket gjinisë femërore, bën që Komisioneri të gjykojë se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë e kanë diskriminuar Znj. L. M. për shkak të gjinisë. Për sa më sipër, mbështetur në parashikimin e nenit 7, pika 1⁷, nenit 12, pika 1, gërma c)⁸, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe nenit 6⁹, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri”, Komisioneri gjykon se Znj. L. M. i është nënshtruar një trajtimi diskriminues për shkak të gjinisë.

Gjykimi i Komisionerit mbështetet fuqimisht edhe në parashikime të akteve të miratuara nga Organizata të ndryshme Ndërkombëtare, ku Shqipëria aderon apo synon të bëhet pjesë e tyre. Parashikime në mbrojtje të grave dhe vajzave e në përgjithësi të gjinisë femërore janë pjesë e akteve të tilla si Konventa e OKB-së “Për elememinimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (2014), e duke vijuar me Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”, si dhe me Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”, të cilat synojnë barazinë gjinore dhe mbrojtjen e gjinisë “femër”, sidomos në marrëdhëniet e punës.

⁷ Neni 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikon: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.”

⁸ Neni 12, pika 1, gërma c), i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” parashikon: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

a) shpalljen e vendeve të lira të punës;

b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;

c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor **apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës**.”

⁹ Neni 6, i ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri” parashikon: “Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. 2. Hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kritereve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njëjës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, përbën diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Nga ky ndalim bëjnë përjashtim rastet kur këto dispozita, kushte, kritere apo praktika justifikohen nga një qëllim i përligjur dhe mjetet apo rrugët për arritjen e këtij qëllimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme.”

2. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “moshën”.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se në Sektorin e Çështjeve Shoqërore, të I.E.V.P. Vlorë, punojnë 1 (një) Përgjegjës Sektori dhe 4 (katër) specialistë.

Znj. L. M. është e datëlindjes 03.10.1963 ose e moshës 55 vjeçe, ndërkohë që edhe Përgjegjësi i këtij Sektori, Z. F. F. është i datëlindjes së vitit 1967 dhe ka moshë të përafërt me ankuesen. Ndërkohë që, ditëlindjet e specialisteve aktuale në këtë sektor i përkasin periudhës kohore 1989 – 1993, ose moshës 25 – 29 vjeçare. Në rastin konkret, rezulton se mosha nuk mund të konsiderohet si shkak diskriminimi, pasi Z. Fakaj është ende i punësuar pranë I.E.V.P. Vlorë, pavarësisht moshës së tij, që është e përafërt me ankuesen.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe nenin 6, të ligjit nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

- 1.** Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “gjinisë”, së Znj. L. M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë.
- 2.** Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “moshës”, së Znj. L. M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë.
- 3.** Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë, për sistemimin në punë të ankueses.

4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak: gjinia
Fusha: punësim)